



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

01 Nr. 401-28652/25
Datë: 26.08.2025

NJOFTIM PËR DËGJIMET BUXHETORE

Bazuar në LIGJI NR. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, LIGJI NR.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal si dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Komuna e Klinës hap procesin e dëgjimeve buxhetore lidhur me Draft Buxhetin e Komunës së Klinës për vitin 2026 dhe vlerësimi për vitin 2027-2028.
Konsultimi publik është i hapur nga **data 26 gusht 2025, deri më 9 shtator 2025.**

Ftohen të gjitha institucionet komunale, Qytetarët, OJQ-të, Bizneset, Bashkësitë Lokale, Mediat dhe grupet tjera të interesit që të marrin pjesë në Dëgjimet Buxhetore për vitin 2026 dhe vlerësimi për vitin 2027-2028., më këtë;

RENDI I DITËS

SHQYRTIMI I DRAFT PLANIT TË BUXHETIT 2026-2028

**Takimi do të mbahet
sipas këtij planifikimi:**

DËGJIM PUBLIK – takim i përgjithshëm me banorët (gra, burra) e të gjitha fshatrave të Komunës së Klinës, qytetit dhe lagjeve, me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave, OJQ, grupet e marginalizuara, shoqata, biznese, media, punëtorë shëndetësor, mësimdhënës, të rinjë/të reja dhe grupe tjera të interesit, takim do të mbahet në **Sallën e Kuvendit Komunal, datë 3.09.2025, ora 16:00.**

Materiali në formë fizike mund të merret në Zyrën e Drejtorisë së Financave, po ashtu, gjendet edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës si dhe Platformën e Konsultimeve Publike:

Komuna Klinë:

<https://kline.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

Platforma e Konsultimeve Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20514&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Propozimet e juaja lidhur me këto akte mund t'i dorëzoni me shkrim në Zyrën e Kryetarit të Komunës, kati II, dhe në zyrën e Drejtorisë së Financave, kati I, zyra e dytë, ana e djathtë.

Gjithashtu, në mënyrë elektronike tek zyrtarët:

1. Drilon Morina, email: drilon.morina@rks-gov.net
2. Melihate Behramaj, email: melihate.behramaj@rks-gov.net;

Mirëpresim propozimet dhe sugjerimet e juaja nga data **26 gusht 2025**, gjatë mbajtjes së debatit dhe deri me datën **9 shtator 2025** nëpërmes mjeteve elektronike.

Pas përfundimit të fazës së diskutimit publik, propozimet e juaja do të merren në konsideratë duke u shqyrtuar në raportin e konsultimit publik si dhe në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës konform dispozitave ligjore.

Kryetari i Komunës
Zenun Elezaj

